

SKEDË INFORMUESE

Thirrje e hapur për projekte “Ngritja e Kapaciteteve në Fushën e Rinisë për Ballkanin Perëndimor” nën Programin e BE-së Erasmus+

Projektet në thirrjen “Ngritja e Kapaciteteve në Fushën e Projekteve Rinore” (ERASMUS-YOUTH-2026-CB-WB) të Programit të BE-së Erasmus+ janë projekte bashkëpunimi ndërkombëtar të bazuara në partneritete shumëpalëshe midis entiteteve aktive në fushën e rinisë në BE dhe vendeve të lidhura me Programin. Kjo thirrje synon ekskluzivisht vendet në Rajonin 1 (Ballkani Perëndimor). Projektet synojnë mbështetjen e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e të rinjve dhe të të mësuarit joformal, si një shtytës i zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik dhe i mirëqenies.

Synimi i thirrjes

Të rrisë kapacitetet e subjekteve rinore në vendet e Rajonit 1 (Ballkani Perëndimor), duke mbështetur përfshirjen e të rinjve në jetën demokratike, nxitjen e sipërmarrjes, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe zhvillimin e metodave të reja të të mësuarit joformal.

Objektivat dhe fushat e ndërhyrjes

Projektet duhet të synojnë:

- rritjen e kapaciteteve të subjekteve që punojnë me të rinj jashtë të mësimit formal;
- promovimin e aktiviteteve të të mësimit joformal, veçanërisht në subjektet që synojnë të rinjtë me më pak mundësi dhe nxisin pjesëmarrjen e të rinjve në të gjithë diversitetin e tyre, me qëllim përmirësimin e nivelit të kompetencave dhe mundësive të tyre për të vepruar, duke i mundësuar kështu ata të sigurojnë pjesëmarrjen aktive të të rinjve në shoqëri;
- mbështetjen e zhvillimit të punës rinore, duke përmirësuar cilësinë dhe njohjen e tij;
- nxitjen e zhvillimit, testimit dhe lançimit të skemave dhe programeve që u lejojnë subjekteve të rrisin lëvizshmërinë e të mësuarit joformal;
- mbështetjen e subjekteve për të kontribuar në zbatimin e Strategjisë së BE-së për të Rinjtë (2019-2027), duke përfshirë 11 Objektivat Evropiane për të Rinjtë; Axhendën Evropiane të Punës për të Rinjtë; Planin e Veprimit për të Rinjtë në Veprimin e Jashtëm të BE-së (2022-2027), dhe në ndjekjen e Vitit Evropian të Aftësive të lançuar në vitin 2023;
- nxitja e bashkëpunimit përmes iniciativave të përbashkëta midis organizatave rinore, nga njëra anë, në Shtetet Anëtare të BE-së dhe vendet e treta të lidhura me programin dhe vendet e treta që nuk janë të lidhura me programin në rajone të ndryshme të botës (Shqipëria është në Rajonin 1);
- nxitja e pjesëmarrjes së subjekteve të vogla dhe subjekteve nga zona të largëta dhe lokalitete më të vogla
- rritja e sinergjive dhe plotësueshmërisë së organizatave rinore që punojnë me të rinjtë jashtë të nxënës formal me sistemet e arsimit formal dhe/ose tregun e punës.

Fushat tematike / Objektivat specifike

Projektet duhet të kontribuojnë në:

- zbatimin e prioriteteve “**Angazho – Lidh – Fuqizo**” të Strategjisë së BE-së për Rininë 2019–2027;
- arritjen e **11 Qëllimeve Evropiane për Rininë** dhe Axhendës Evropiane të Punës Rinore;
- fuqizimin e të rinjve me më pak mundësi dhe sigurimin e aksesueshmërisë;
- zhvillimin e mjeteve dhe metodave inovative të të nxënit joformal, përfshirë edukimin mediatik;
- promovimin e dialogut ndërmjet të rinjve dhe vendimmarrësve;
- përdorimin efektiv të mjeteve digjitale për bashkëpunim dhe mësim.

Rezultatet e pritura

Projektet duhet të demonstrojnë ndikimin e tyre përmes:

- rritjes së kapaciteteve dhe profesionalizmit të organizatave rinore;
- rritjes së pjesëmarrjes së të rinjve në jetën demokratike dhe vendimmarrje;
- përmirësimit të aftësive sipërmarrëse, digjitale dhe inovative të të rinjve;
- forcimit të bashkëpunimit transnacional dhe të të nxënit ndërkulturor;
- përfshirjes së grupeve me më pak mundësi;
- shpërndarjes efektive dhe tërheqëse të rezultateve tek të rinjtë dhe komunitetet lokale;
- krijimit të lidhjeve me komunitetet lokale, duke nxitur ide inovative dhe mundësi punësimi.

Aktivitetet e pranueshme

Aktivitetet duhet të lidhen drejtpërdrejt me objektivat e thirrjes dhe të fokusohen në ndërtimin e kapaciteteve të organizatave rinore, veçanërisht në Rajonin 1 (Ballkani Perëndimor). Ato mund të përfshijnë, ndër të tjera:

- krijimin dhe forcimin e rrjeteve ndërkombëtare rinore;
- shkëmbimin e praktikave më të mira dhe të njohurive;
- zhvillimin dhe zbatimin e trajnimeve dhe aktiviteteve të përbashkëta;
- zhvillimin, testimin dhe zbatimin e metodave dhe mjeteve të reja të të nxënit joformal;
- mobilitet të stafit dhe të rinjve në kuadër të të nxënit joformal;
- aktivitete për ndërgjegjësim, dialog rinor dhe pjesëmarrje qytetare;
- aktivitete për përhapjen dhe shfrytëzimin e rezultateve të projektit.

Kush mund të aplikojë

Aplikantët (përfituesit dhe subjektet e lidhura) duhet të jenë:

- subjekte juridike publike ose private;
- aktive në fushën e rinisë dhe/ose punës rinore;
- të themeluara ligjërisht në:
 - një Shtet Anëtar të BE-së ose vend të asociuar me Programin, ose
 - një vend të tretë jo të asociuar me Programin nga Rajoni 1 (Ballkani Perëndimor).
- OJQ-të (duke përfshirë OJQ-të Rinore Evropiane dhe Këshillat Kombëtare Rinore) që punojnë në fushën e rinisë ose
- organet publike në nivel lokal, rajonal ose kombëtar që punojnë në fushën e rinisë;

- organizata të tjera publike ose private gjithashtu mund të marrin pjesë, por jo si koordinatorë.

I njëjti subjekt mund të paraqesë si koordinator vetëm një aplikim deri në afatin e caktuar brenda të njëjtës thirrje.

Konsorciumi

Projektet janë transnacionale dhe duhet të përfshijnë të paktën **4 entitete nga minimumi 3 shtete**, me kushtet:

- minimum 1 dhe maksimum 2 subjekte nga BE ose vende të asociuara me Programin;
- minimum 2 subjekte nga të paktën 1 vend i tretë jo i asociuar me Programin nga Rajoni 1 (Ballkani Perëndimor);
- numri i subjekte nga BE/vendet e asociuara nuk mund të jetë më i madh se numri i entiteteve nga vendet e treta jo të asociuara.

Kohëzgjatja e projekteve:

Projektet normalisht duhet të zgjasin nga 12 deri në 36 muaj (zgjatjet janë të mundshme, nëse justifikohen siç duhet).

Buxheti:

ERASMUS-YOUTH-2026-CB-WB

Ngritja e Kapaciteteve në Fushën e Rinisë – Ballkani Perëndimor

- **Buxheti total: 3 490 000 EUR**
- **Buxheti për projekt:** Projektet brenda rajonit 1 mund të përfitojnë një kontribut maksimal nga Bashkimi Evropian deri në 300 000 euro për projekt.

Si bëhet aplikimi:

Aplikimet dërgohen përmes sistemit të BE-së Funding and Tenders. Anekset që duhet të plotësohen dhe vendosen në sistem janë:

- Application Form Part A që plotësohet online
- Application Form Part B (Paketa e Application Form dhe Buxhetit) që shkarkohet, plotësohet dhe ngarkohet online
- Part C që plotësohet online

Kur është afati i fundit:

- Afati i fundit: **26 shkurt 2026, ora 17:00 (ora e Brukselit)**

Linku i thirrjes:

<https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/topic-details/ERASMUS-YOUTH-2026-CB-WB>